



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:114603

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05527949

PAKR.nr.37/24

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku - kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Xhevdet Abazi - anëtarë të kolegjit, me praktikanten gjyqësore Erna Stublla si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. H për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par 1 nënpar 1.5 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëseve të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shefkiu dhe av. Admir Salihu, e ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, 2023:114603 i datës 30.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 27.03.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësve të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shefkiu dhe av. Admir Salihu, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për të Krime të Rënda, 2023:114603 i datës 30.11.2023, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m i

Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për të Krime të Rënda, me aktgjykimin 2023:114603 të datës 30.11.2023, të akuzuarin A. H për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 173 par 1 nënpar. 1.5 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje pesë (5) vite, ndërsa për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë njëmijë euro (1000 €).

Konform neni 76 par.1 dhe 2, nënpar. 2.5 të KPRK-së, të akuzuarin A. H për shkak të veprave penale të theksuara më lartë, e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 22.05.2023 deri më 21.11.2023 dhe dënim me gjobë më shumë njëmijë euro (1000 €), të cilin dënimi pandehuri është obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Është udhëzuar i akuzuari që në rast se dënimin me gjobë nuk mund të ekzekutohet në forma tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet euro (20 €) do të i llogaritet një ditë burgimi.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, të akuzuarit i është konfiskuar në mënyrë të përhershme pistoleta e tipit "Zoraki" M906-B, e kalibrit 7.65 x 17mm, më numër serik ..., prodhim turk dhe një karikator pa fishekë.

Janë udhëzuar në kontest civil të dëmtuarit D. V, A. A dhe A. M për realizimin e kërkesës juridiko pasurore.

Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë pesëdhjetë euro (50 €), në emër të shpenzimeve procedurale (për ekspertizën mjeko ligjore) të paguaj shumë njëzet euro (20 €) si dhe në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Dhunës të paguaj shumë pesëdhjetë euro (50.00 €), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formë të prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësit e të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shekfiu dhe av. Admir Salihu, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën e tyre dhe ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, 2023:114603 i datës 30.11.2023, ashtu që të akuzuarit A. H të i shqiptojë një dënim më të lehtë.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.52/2024 e datës 25.01.2024 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësve të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shekfiu dhe av. Admir Salihu, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, 2023:114603 i datës 30.11.2023, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë i akuzuari A. H, mbrojtësit e të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shekfiu dhe av. Admir Salihu, pala e dëmtuar D. V dhe pala e dëmtuar A. A, ndërsa Prokurori i Apelit dhe palae dëmtuar A. M nuk prezantuan në seancë, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Pala e dëmtuar D. V në seancën e kolegjit deklaroi se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, me të akuzuarin i kemi rregulluar raportet dhe nuk paraqesim as kërkesë pasurore- juridike. Pala e dëmtuar A. A deklaroi se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, me të akuzuarin i kemi rregulluar raportet dhe nuk paraqesim as kërkesë pasurore- juridike. Mbrojtësja e të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shekfiu deklaroi se nga data 21.11.2023 kur të akuzuarit i është ndërprerë masa e paraburgimit, i njëjti asnjëherë nuk është përfshirë në ndonjë veprë penale apo keqkuptim me palët e dëmtuara. Konsiderojmë se kjo është rrethanë për zbutjen e dënimit. I akuzuari A. H deklaroi se e mbështes avokaten time dhe shtoj që me palën e dëmtuara i kemi raportet e mira.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shekfiu dhe av. Admir Salihu, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shekfiu dhe av. Admir Salihu

Mbrojtësit e të akuzuarit konsiderojnë se Gjykata e shkallës së parë të mbrojturit të tyre i ka shqiptuar një dënim mjaft të ashpër duke marrur parasysh faktin se i akuzuarit ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, ka shprehur keqardhjen e tij për kryerjen e veprës dhe pendimin e thellë

për veprimet e tij inkriminuese, ka arritur pajtim më të dëmtuarit, pasojat e veprimeve të tij kanë qenë të natyrës së lehtë, lëndimet që i ka pësuar i dëmtuari janë lëndime të lehta dhe jo të drejta për drejta nga predha, por nga thyerja e xhamit të veturës, që dëshmon se i akuzuari nuk ka pasur për qëllim vrasjen e të dëmtuarit.

Gjithashtu, mbrojtja pretendon se përpos rrethanave lehtësuese të cilat i ka gjetur Gjykata e shkallës së parë, tek i akuzuarit gjenden edhe rrethana të tjera lehtësuese siç është mosha e re, karakteri i mire i mëparshëm, si dhe rrethanat që tregojnë rrezik të ulët të përsëritjes së veprës, të cilat ndërlidhen me pendimin dhe përpjekjet për kompensim, rrethanat e kryerësit dhe hapat e ndërmarrë drejt rehabilitimit, siç është pajtimi dhe kërkim falja menjëherë pas daljes nga masa e paraburgimit. Madje, sipas mbrojtjes karakteri i mirë i të akuzuarit është dashur të konsiderohet relevant për matjen e dënimit pasi që tregon se sjellja kriminale nuk është pjesë e sjelljeve të zakonshme të akuzuarit, rrethanë kjo që ndërlidhet edhe me faktorët e tjerë si pranimi i fajësisë, bashkëpunimi me organe, dorëzimi vullnetar, pendimi, kërkim falja, si dhe inicimi jashtëgjyqësor për kompensimin e viktimës.

Për më tepër, mbrojtja thekson se është rrethanë relevante edhe niveli i dëmit të shkaktuar nga vepra penale, sepse në rastin konkret i akuzuari është ngarkuar me vepër të rëndë, mirëpo shkalla e dëmit të shkaktuar nga kjo vepër penale është më e ulët se ajo e theksuar me dispozitën e kësaj vepre penale në Kod. Kjo sepse është konstatuar edhe nga raporti mjekësor se dëmi i shkaktuar është lëndim i lehtë trupor, i cili nuk është pasojë e drejtpërdrejtë nga kryesi.

Mbrojtja konsideron se Gjykata e shkallës së parë ka mund të bëjë zbutjen e dënimit edhe më shumë për shkak që baraspesha e rrethanave lehtësuese ka qenë dukshëm më e madhe se ajo rënduese ose e thënë më saktë rrethanat rënduese nuk ka pasur përpos natyrës së veprës penale.

#### Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Ndonëse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me ketë bazë ankimore meqë i akuzuar ka pranuar

fajësinë). Prandaj, aktgjykimi u vlerësua vetëm lidhur me pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shekfiu dhe av. Admir Salihu, sa i përket vendimit mbi sanksionin penal.

### Vlerësimi i Gjykatës lidhur me vendimin mbi dënim

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit konstaton se pretendimet e mbrojtësve të akuzuarit A. H, av. Arbnora Shekfiu dhe av. Admir Salihu janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar faktin se i akuzuari është penduar për kryerjen e veprave penale dhe është zotuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale apo të ngjashme, ka shprehur keqardhje, i ka kërkuar falje të dëmtuarve dhe me të njëjtit është pajtuar. Ndërkaq në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, Gjykata e shkallës së parë si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë, andaj mbi bazën e këtyre rrethanave Gjykata e shkallës së parë aplikoi institutin e zbutjes së dënimit konform nenit 71 dhe 72 par.1 nenpar.1.1 të KPRK-se, kështu duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Ndërsa, pretendimi i mbrojtësve të akuzuarit se rrethanat lehtësuese të theksuara në aktgjykimin e ankimuar nuk janë vlerësuar mjaftueshëm, si dhe pretendimi që Gjykata e shkallës së parë nuk vlerësuar si rrethanë lehtësuese si faktin që pasojat e veprimeve të akuzuarit kanë qenë të natyrës së lehtë dhe të shkaktuara nga thyerja e xhamit të veturës e jo nga predha, moshën e re të akuzuarit, karakterin e mirë të mëparshëm, si dhe rrethanat që tregojnë rrezikun e ulët të përsëritjes së veprës, janë pretendime të pabazuara pasi në rastin konkret këto rrethana lehtësuese veç se kanë qenë objekt i vlerësimit të Gjykatës së shkallës së parë dhe si rezultat i tyre, të akuzuarit Gjykata e shkallës së parë i ka shqiptuar dënimin përkatës nën minimumin e paraparë me KPRK. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kësaj Gjykate janë bazë e mjaftueshme për arsyetimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.37/24, datë 27.03.2024

Praktikantja gjyqësore

Erna Stublla

Anëtarët e kolegjit

Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar i kolegjit

Hashim Çollaku

---

---

---

Xhevdet Abazi

---